



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK

NJOFTIM PËR RENDIN E DITËS
Mbledhje Jashtëzakondshme
Me Mjete Të Komunikimit Elektronik

Në mbështetje të nenit 57 pika 2/c të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, të nenit 51, të Rregullores së Funkcionimit të Këshillit Bashkiak Durrës, Aktit Normativ të Këshillit Ministrave nr.3, datë 15.03.2020 “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19“, neni 5 “Vendimmarrja nga Organet Kolegjiale,, Këshilli Bashkiak Durrës,

NJOFTON:

DITËN E PREMTE, DATA 05.02.2021, ORA 12:00, KËSHILLI DO TË MBAJË NJË MBLEDHJE TË JASHTËZAKONDSHME NËPËRMJET MJETEVE TË KOMUNIKIMIT ELEKTRONIK, ME KËTË REND DITE:

****	MIRATIMI I RENDIT TË DITËS TË MBLEDHJES
1. Shqyrtim dhe miratim i projekt-vendimit	PËR RIALOKIMIN E FONDEVE TË PËRFITUARA NË FORMËN E TRANSFERTËS SË PAKUSHTËZUAR NGA FONDI I RINDËRTIMIT I BUXHETIT TË SHTETIT ME VLERË 1,241,641,916 LEKË TË PASHPENZUARA NË VITIN 2020, QË DO TË TRASHËGOHEN NË VITIN 2021

Në mbështetje të nenit 5 të Aktit Normativ të Këshillit Ministrave nr.3, datë 15.03.2020, të nenit 33, neni 34/1, neni 77 /8 të Rregullores së Funkcionimit të Këshillit Bashkiak Durrës, anëtarët e Komisionit të Këshillit Bashkiak pasi shqyrtojnë me njëri tjetrin elektronikisht projektvendimin

përkatës, dërgojnë me email propozimin e tyre (RAPORTIN) mbi projektvendimin sipas grafikut të mëposhtëm.

Data 04.02.2021

Pika 1, do të shqyrtohet nga:

- Komisioni i Buxhetit, Financës dhe Taksave-Tarifave
dhe do të sjellin me e-mail Raportin e tyre për këtë projektvendim brenda orës **20.30**.

SEKRETARE KËSHILLIT BASHKIAK DURRËS

Dorina Milja